

BERZH PIRANJANI

ARMENIA

**KY SKAJ I HARRUAR
I EUROPËS PELLAZGJIKE**

BERZH PIRANJANI

ARMENIA

**KY SKAJ I HARRUAR
I EUROPËS PELLAZGJIKE**

Tiranë, 2023

Përgatiti për shtyp: Berzh Piranjani

Redaktoi: Berzh Piranjani

Art Grafik: Orest Muça

Mundësuan botimin:

Berzh dhe Varuzhan Piranjani

Tirazhi 100 kopje

ISBN: 9789928343185

PËRMBAJTJA

1. Në vend të Hyrjes:
Artak Movsisjan: “Historia e Armenisë” 5
2. Parathënie 7
3. Parashtrësë: “Pikat mbi të cilat do të orientohet punimi” 8
4. Prejardhje e përbashkët IndoEuropiane 12
5. Kontakti me botën dhe edukatën Helene, civilizimin Romak dhe ideologjinë e Krishterë përgjatë rrugëtimit të gjatë e të përbashkët historik me forcën e mbijetesës ndën pushtetin Aleksandrin, Romak, Bizantin dhe atij Turk, dhe përvetësimi i atyre elementeve pozitivë, që sot përbëjnë bazën e qytetërimit European..... 13
6. Lidhjet e ngushta historike me kanceleritë Europiane 26
7. Armenët dhe Bashkësia e popujve Europeanë 27

NË VEND TË HYRJES

ARTAK MOVSISJAN

“HISTORIA E ARMENISË”

Botim i “albPAPER”, Tiranë, 2019

Në fillim të viteve 1980 u konfirmua, që atdheu i stërllashtë i botës Indo-Europiane në mijëvjeçarin e 5^{të} – 4^t para Krishtit, ishte zbuluar në veri të Azisë Perëndimore, më saktësisht, në Malësitë Armene, në krahinat lindore të Azisë së Vogël, ndërmjet Mesopotamisë veriore dhe krahinave veri-perëndimore të zëna nga pllaja Iraniane. Kështu, atdheu i stërllashtë i Indo-Europianëve është gjetur pikërisht brenda asaj hapësire ku është formuar dhe nëpër të cilën ka kaluar historia e popullit Armen.

(Historia e Armenisë, fq. 18-19)

Sot mund të thuhet me bindje të plotë, që Armenët janë pjesë e kombit mëmë IndoEuropian, dhe duhet të jenë ndarë prej saj (dalë si degëzim më vete) nga fundi i mijëvjeçarit të 4^t para Krishtit (sipas disa studimeve të kohëve të fundit mendohet që kjo ndarje të ketë ndodhur në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të 6^{të} para Krishtit). Rreth atyre kohëve, tributë Armene fillojnë të marrin formën e “etnisë” dhe të shfaqen format e para të organizimeve

“shtetërore”, dhe vetëm në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të parë para Krishtit, Armenët shfaqen si një organizim shtetëror mbarëArmen i unifikuar.

(Historia e Armenisë, fq. 20)

PARATHËNIE

Gjatë kohës që punoja për librin “Indo-Europa; Shqiptarët dhe Armenët; Shqipja dhe Armenishtja” një mendim në formë pyetjeje, të cilën e kam formuluar më poshtë, më vërtitej pa pushim në kokë: “Shqiptarët dhe Armenët – kaq shumë ngjashmëri?; Shqipëria – copë toke në Europë, Armenia – copë toke në Azinë e Vogël; Armenia – nyje lidhëse e Persisë Aziatike me Shqipërinë Europiane; Armenia, si pjesë e Anatólisë lindore dhe qendrore, në etapa të ndryshme kohore e pa veten edhe si pjesë përbërëse e perandorisë Perse, e perandorisë Aleksandrine, e perandorisë Romake, e perandorisë Bizantine, e perandorisë Otomane, e perandorisë Ruse”. Pak a shumë një histori e ngjashme me atë të kombit shqiptar ndër shekuj.

Pozicionin e Shqipërisë, Shqipes dhe Shqiptarëve në hapësirën IndoEuropiane të zhvillimit të racës njerëzore jam përpjekur ta trajtoj në librin e sipërpërmendur “Indo-Europa; Shqiptarët dhe Armenët; Shqipja dhe Armenishtja”. Po kështu në të, si edhe në referatin përmbledhës “Ura Pellazgjike” (botim i B.Piranjani, 2022), në pikën ku trajtohet “Pozicioni i Shqiptarëve dhe Armenëve në Boshtin Indoeuropian të racave dhe gjuhëve dhe afërsia ndërmjet tyre” vihet në dukje afëria që kanë këta dy popuj dhe këto dy gjuhë ndërmjet tyre, pavarësisht asaj që na duket distancë e madhe ndërmjet dy vendeve, njeri në atë pjesë të kontinentit që emërtohet Europë dhe tjetri në skajin lindor të Azisë së Vogël, në skajin lindor të Anatólisë.

Pasi lexon librin “Rrëmbimi i Europës” me autor Aurel Plasari, që sipas mendimit tim përbën një analizë të shkëlqyer mbi pozicionin e Shqipërisë në këtë bashkësi kombesh e shtetesh të emërtuar “Europë, të duket se natyrshëm të vjen përgjigja edhe për pyetjen:

Kur Armenët dhe Shqiptarët kanë kaq shumë të përbashkëta, atëhere:

PO ARMENËT, NË Ç’RAPORT JANË ME BASHKËSINË E POPUJVE EUROPIANË?

Çdo europiani që e njeh sadopak historinë e kombit Armen, aq më tepër kur ka patur edhe rastin tani së fundmi ta vizitojë Republikën e Armenisë së sotme (atë pjesë të Armenisë së mbetur nga Armenia e lavdisë së dikurshme) dhe të bjerë në kontakt me njerëzit e atjeshëm, nuk mund të mos i bjerë në sy afëria europiane e ambientit. Të njëjtën gjë që pata ndjerë edhe unë kur qeshë për herë të parë në Armeni; veçanërisht më e theksuar kjo shfaqej në kryeqytetin e saj, Erevan.

E më pas, teksa lexoja librin “Rrëmbimi i Europës” të Aurel Plasarit, m’u duk se kisha rënë në kontakt me përgjigjen e pyetjes që më vërtitej në kokë për gjatë gjithë kësaj kohe.

Ashtu si tek Shqiptarët dhe popujt e tjerë europianë, tek Armenët gjeta atë element bazë, që sipas disa prej mendjeve të ndritura filozofike europiane përbën elementin lidhës të atij grupimi që sot formon Bashkimin Europian (BE): kulturën e përbashkët europiane. Ja ç’thotë A. Plasari në librin e tij “Rrëmbimi i Europës”:

“Është e njohur formula e Gëtes (Goethes), të cilën ai ia transmetonte sekretarit të tij: “Çfarë e bashkon Europën është kultura, ndërsa çfarë e ndan janë idetë politikë” (Gespräche, 14 Maj 1808). (Fq. 85)”

Dhë poshtë:

“... mbetet ende në fuqi pyetja: Ç’është Europa? ...

Përgjigjen kësaj pyetjeje ja ka dhënë historia dhe ajo vjen pak a shumë kështu: Europa nuk është një strukturë thjesht gjeografike, por një strukturë piksëpari kulturore, gjë që mendimtarë si Gëteja (Goetheja) e kishin kuptuar qysh moti. Kufijtë e kësaj Europe kanë qenë vendosur në bazë të shpirtit, frymës, dhe jo mbi parime gjeofizike. Poeti dhe mendimtari Pol Valery i ka pas dëftuar këta kufij realë në një ese me titull “La crise de l’esprit”, të pranuar botërisht si “manifesti europian” prej etërve të integritimit europian (Nouvelle Revue Française, nr.8, 1919). Simbas Valerysë: Europa ekziston atje ku zotëron ndikimi i besimit të krishterë, i botës latine dhe i letërsisë helene. Pra: as bota greke vetëm, dhe as ajo latine vetëm, pa Krishterimin, nuk kanë mundur të konstitujnë Europën. (Fq. 86 - 87)”

Mirëpo këto janë tipare të dallueshme që i përkasin një kohe relativisht të vonë të historisë së zhvillimit të racës njerëzore. Po më përpara?

Natyrisht, Armenia ka edhe specifikat e saj të veçanta si komb dhe ndikimet e influencave të huaja mbi të që kanë lënë gjurmë përgjatë shekujve, por në tërësinë e formimit të vet Armenia të bën të ndjehesh si në çdo vend tjetër europian dhe vetë Armenët në sjelljen e tyre dhe në bashkëbisedim shfaqin të njëjtat tipare të një europiani normal. Madje edhe temat e bisedave janë tipike si ato të dy europianëve ndërmjet tyre. Kjo, të paktën, me aq sa e njoh unë Europën kontinentale.

Nuk dallon në ta tiparet tipike aziatike, as veshjet tipike aziatike, aq më pak sjelljen patriarkaliste, që mund të rrjedhë nga besimi fetar dominues në Azi.

Atëhere, vetvetiu të rilind pyetja: Ku qëndron sekreti i kësaj dukurie, i këtij populli me vendndodhje në Azinë e Vogël, por me

mënyrë jetese Europiane? Çfarë e lidh atë me Europën? Çfarë i lidh në themel Armenët me Bashkësinë e popujve Europianë?

Përgjigja që do kërkonte kjo pyetje do të ishte ajo e shprehur më sipër nga Artak Movsisjan në librin e tij “Historia e Armenisë”:

“PREJARDHJA E PËRBASHKËT INDOEUROPIANE”

Një temë e madhe, e gjerë dhe e thellë, pa anë e pa fund, të cilën jam përpjekur ta trajtoj brenda mundësive të mia mbi bazën e studimeve të autorëve Shqiptarë, Armenë dhe të tjerë në librin me titull “Indo-Europa; Shqiptarët dhe Armenët; Shqipja dhe Armenishtja”.

Të studiosh prejardhjen e përbashkët IndoEuropiane të Armenëve me secilin prej vendeve Europiane brenda një kohe relativisht të shkurtër do të ishte një punë pothuajse e pamundur për çdo grup studiuesish dhe jo më për një njeri të vetëm.

Por këtu mendoj se më vjen në ndihmë historia e Shqipërisë. Një vend, një popull dhe një gjuhë që kanë tërhequr fuqimisht vëmendjen e studjuesve të huaj, të paktën këta dy shekujt e fundit, pa përmendur këtu kontributin e studjuesve arbëreshë apo shqiptarë, të cilët e kanë parë problemin jo vetëm si detyrim shkencor por edhe detyrim shpirtëror, që rrjedh nga thirrja e të parëve.

Të analizosh afëritë ndërmjet këtyre dy popujve dhe mbi bazën e asaj që e lidh sot kombin shqiptar me bashkësinë e kombeve, që përbëjnë Bashkësinë Europiane, të mundesh të nxjerrësh përfundime për pyetjen që ngrihet:

ÇFARË I LIDH ARMENËT ME BASHKËSINË E POPUJVE EUROPIANË?

ja, kjo ishte detyra që i vura vetes, dhe ja kështu, nëpërmjet sa më poshtë po përpiqem të parashtoj, u përpoqa t'i jap përgjigje pyetjes së mësipërme:

PARASHTRESË

Në këtë referim i kam vënë vetes detyrë të trajtoj shkurtimisht temën:

ÇFARË I LIDH ARMENËT ME SHQIPTARËT DHE ME BASHKËSINË E POPUJVE EUROPIANË?

Pasi e analizova problemin, arrita në përfundimin se elementet kryesore që përcaktojnë afërinë ndërmjet tyre janë këto, të renditura si më poshtë:

1. Prejardhje e përbashkët IndoEuropiane.
2. Kontakti me botën dhe edukatën Helene, civilizimin Romak dhe ideologjinë e Krishterë përgjatë rrugëtimit të gjatë e të përbashkët historik me forcën e mbijetesës ndën pushtetin Aleksandrin, Romak, Bizantin dhe atij Turk, dhe përvetësimi i atyre elementeve pozitivë, që sot përbëjnë bazën e qytetërimit European.
3. Lidhjet e ngushta historike me kanceleritë Europiane (Të sillet shembulli mbretit Levon II^{të} dhe Levon IV^t)

Pikat e sipërparaqitura po i ilustron shkurtimisht si më poshtë:

I PREJARDHJE E PËRBASHKËT INDOEUROPIANE

Duke qenë se kjo temë është trajtuar hollësisht në parashtrësën “Ura Pellazgjike” dhe pikërisht në pjesën ku trajtohet “Pozicioni i Shqiptarëve dhe Armenëve në Boshtin IndoEuropean të racave dhe gjuhëve dhe afërsia ndërmjet tyre” nuk do të zgjatem në të.

Shkurtimisht, ashtu siç është trajtuar në temën e mësipërme, më poshtë po rendis pikat e takimit ndërmjet këtyre dy popujve, të cilat, sipas meje, do të formonin këmbët e urës lidhëse me popujt e tjerë të Bashkësisë IndoEuropiane:

1. Prejardhje e përbashkët Xhapatike
2. Prejardhje e përbashkët Pellazgjike
3. Pjesëmarrës të njëkohshëm në luftën e Trojës
4. Origjinat Ariane të Armenëve dhe Shqiptarëve
5. Origjinat Armene dhe Shqiptare të Etruskëve
6. Origjinat Armene dhe Shqiptare të Baskëve
7. Ngjashmëritë antropologjike ndërmjet Armenëve dhe Shqiptarëve
8. Ngjashmëritë gjuhësore ndërmjet gjuhëve Armene dhe Shqipe
9. Pema e gjuhëve IndoEuropiane

II

KONTAKTI ME BOTËN DHE EDUKATËN HELENE, CIVILIZIMIN ROMAK DHE IDEOLOGJINË E KRISHTERË PËRGJATË RRUGËTIMIT TË GJATË E TË PËRBASHKËT HISTORIK ME FORCËN E MBIJETESËS NDËN PUSHTETIN ALEKSANDRIN, BIZANTIN DHE ATIJ TURK, DHE PËRVETËSIMI I ATYRE ELEMENTEVE POZITIVË, QË SOT PËRBËJNË BAZËN E QYTETËRIMIT EUROPIAN

Këtë pikë mendova ta ndaj në dy nënpika:

1. Në ç'raport janë Shqipëria dhe Shqiptarët me Bashkësinë e popujve Europianë?
2. Armenët dhe Bashkësia e popujve Europianë

Fillimisht duhet sqaruar së çfarë duhet të kuptojmë me termin Europë dhe çfarë përfaqëson ajo që sot njihet si Bashkimi Europian apo Europa e Bashkuar.

Këtu na vjen në ndihmë trajtimi që i bën A. Plasari konceptit Europë si bashkësi kombesh me lidhje jo vetëm territoriale, por edhe shpirtërore të fuqishme midis tyre, në librin “Rrëmbimi i Europës”, i cili në fakt, në analizën që i bën problemit se çfarë përfshin termi “Europë”, ka dalë edhe me një konkluzion mbi pozicionin e Shqipërisë në këtë bashkësi kombesh e shtetesh të emërtuar “Europë”. Në fund të fundit për mendimin tim ai shkrim është një analizë e shkëlqyer e elementeve që formojnë “Shtëpinë Europiane” dhe një përgjigje jo më pak shtruese e pyetjes:

1. NË Ç'RAPORT JANË SHQIPËRIA DHE SHQIPTARËT ME BASHKËSINË E POPUJVE EUROPIANË?

Duke i kërkuar ndjesë Z. Plasari për përdorimin e shkrimit të tij lidhur me afërinë Europiane të Shqipërisë me tërësinë e kombeve dhe shteteve, që sot janë bashkuar në atë formacion, që quhet Bashkimi European, me qëllim që të mund të kemi një bazë krahasuese për të bërë një analizë lidhur me pozicionin e Armenisë dhe Armenëve përkundrejt Bashkimit European, më poshtë japim disa citime nga vepra e tij “Rrëmbimi i Europës”, që do të mund të na ndihmonin në kuptimin dhe trajtimin e problemit.

(Intermezzo)

Duke lexuar librin “RRËMBIMI I EUROPËS”

me autor Aurel Plasari

(Mars 2022)

“EUROPA NGA RRËNJËT” (Fq. 5)

Në vitin 212 të erës sonë perandori Karakalja (Caracalla) kryente një akt nga ata që ngrenë peshë vendimtare në evoluimin historik të shoqërisë njerëzore: nxirrte ediktin nëpërmjet të cilit u jepte qytetarinë romane të gjithë banorëve të perandorisë. Ky akt dëshmonte shtrirjen e një mendësie të përbashkët mbi territorin perandorak. Duke i ngulitur tagret e individit në një kod të urtë ligjesh, e drejta romane, një nga konstruksionet më gjeniale të mendjes njerëzore, do të zbatohej tani e tutje pa diskriminime. Nëpërmjet këtij akti legjislativ perandori shenjonte përmbylljen e një procesi: të romanizimit të krejt sipërfaqes tokësore sa ndodhej në zotërimin e tij. (Fq. 5)

“Datëlindjen e Europës shpirtërore dhe mendore filozofi gjerman Edmund Husserl e cakton në shekujt VII – VI p.e.s. në ndërkohën e lulëzimit të filozofisë jonikë, ... (Fq. 7)

Ndodhi atëhere një revolucion në mendësinë njerëzore, ... (Fq. 7)

... një nga rrjedhohat e kësaj mendësie ishte shfaqja e demokracisë në Greqinë e lashtë, ngjarje që i ka vënë vulën e vet evoluimit të njerëzimit në të gjitha rrafshet. (Fq. 7)

Nëpërmjet kolonizimit helenët e përhapën këtë mendësi në pellgun e Mesdheut, deri në Detin e Zi. (Fq. 8)

Funksionin kulturor që patën kryer kolonitë e themeluara nga helenët, tani e merrte përsipër në shkallë kontinentale Roma. (Fq. 8)

(“U mundëm nga Greqia e mundur” thoshte Ciceroni), .. (Fq. 8)

Kur një analist si Ladouce, në ndryshim nga Husserli, ka vërejtur se “Europa u lind nga takimi providencial i një perandorie dhe një feje”, fjalën e ka për kohën e Krishtit, gjatë së cilës Perandoria romane arriti apogjeun e vet nën perandorët August e Tiber. (Fq. 9)

Shartimi i idealit të krishterë mbi konceptin perandorak romak e ka vulosur historinë e Europës, të cilën nuk ka “filozof” që ta zhvulosë. (Fq. 9)

Në këtë shartim dhe askund tjetër, u hodhën themelet e atij qytetërimi që sot e quajmë “europian”, të organizuar e administruar më së miri, sipas strukturash që janë mbajtur në këmbë ende sot e gjithë ditën. (Fq. 9 - 10)

Shënim B.P.:

“Nxjerrë nga Wikipedia”

Theodosius I (11 janar 347 - 17 janar 395), i quajtur gjithashtu Theodosius i Madh, ishte perandor romak nga 379 deri në 395

Pas negociatave që me gjasë zgjatën të paktën disa muaj, romakët dhe gotët më në fund përfunduan një marrëveshje më 3 tetor 382. Në këmbim të shërbimit ushtarak në Romë, gotët u lejuan të vendoseshin në disa pjesë të tokës romake në jug të Danubit. Kushtet ishin jashtëzakonisht të favorshme për gotët, duke reflektuar faktin

se ata ishin të ngulitur në territorin romak dhe nuk ishin dëbuar. Domethënë, në vend që t'i nënshtroheshin plotësisht autoritetit romak, ata u lejuan të mbeteshin autonomë nën udhëheqësit e tyre, duke mbetur kështu një organ i fortë dhe i unifikuar. Gotët e vendosur tani brenda Perandorisë do të luftonin kryesisht për romakët si një kontigjent kombëtar, në kundërshtim me integrimin e plotë në forcat romake.

Duke u bërë mandej qendra e Krishterimit, Roma përcaktoi atë njësi (unitet) që u quajt Chistianitas. Kjo njësi solidarizonte – dhe solidarizon ende sot – popujt e lindur prej rrënojave të Perandorisë. (Fq. 11)

Për këtë arsye çdo arritje e rregjistruar nga Krishterimi do të thoshte, dashur pa dashur, një shtrirje të mëtejshme të rrezes së veprimit të mendësisë greko-romane nëpërmjet latinishtes. (Fq. 12)

Sa u përket marrëdhënieve të Shqipërisë me sferën shpirtërore e mendore latine, një konkluzion tejmase sintetik i Eqrem Çabejt, që e kam cituar disa herë dhe do të më pëlqente ta përsëris, është ky: “Shqipëria ka qenë e orientuar më tepër nga Perëndimi sesa fqinjët e saj. Midis gjithë vendeve ballkanike, - edhe Rumania, me gjithë idiomën roman të saj, e papëryshuar, - Dalmacia dhe Shqipëria, pastaj Ishujt Jonikë janë vendet që kanë qenë më tepër direkt të çelura ndaj influencës kulturore të Perëndimit” (Për gjenezën, 18). (Fq. 31)

Në mënyrë të posaçme kjo është lidhur me rethanat e reja të krijuara gjatë përfshirjes së viseve Ilire në Perandorinë romane. (Fq. 31)

Kështu ndodhi që Krishterimi, më pak ai lindor dhe më shumë ai perëndimor, filloi të quhej emërues i përbashkët për popujt që mëtojnë të jenë europianë, ... (Fq. 33)

Te “Vija e Teodosit rishfaqet” mendimin e tij për këtë çështje Aurel Plasari e ka shprehur shtjellimisht: “Nëse sot në Europë vihet re një prirje për ta refuzuar Islamin, kjo prirje bart, pa dyshim, efekte negative për të ardhmen e bashkuar të kontinentit” (“Vija e Teodosit rishfaqet”, f. 52-53). (Fq. 41)

“Nëse Europa duhet ta marrë seriozisht çështjen Islame, kjo jo për “keqardhje” apo “tolerancë”, por sepse aktualisht ajo ka nevojë për Islamin, si për fetë e tjera të mëdha” (“Vija e Teodosit rishfaqet”, f. 52-53). (Fq. 42)

Ekonomisti i madh Jean Monnet, njeri nga ata që më së shumti patën kontribuar për ndërtimin e bashkësisë europiane mbi baza të ekonomisë e të teknologjisë, dëftoi në fund të jetës së tij një intuitë gati profetike duke deklaruar se, nëse puna duhej nisur nga e para, ai do t’ia fillonte nga kultura ... *Kultura është ajo lidhje e fuqishme që mund të çojë jo tek bashkimet sipërfaqësore, por tek rrënjët e përbashkëta*). (Fq. 44)

Më poshtë Aurel Plasari thekson faktin se rrënjët e përbashkëta, ato që qëndrojnë në themel të ngrehinës “Bashkimi European”, europeanët i gjejnë “... të kredhura te tradita e tyre qytetërimore që përfshin në sintezë edukimin helen, të drejtën romane dhe besimin e krishterë, sikurse mendimtari Paul Valery i ka pasë përshkruar. Është fjala për rrënjë që nuk përfaqësojnë thjesht të kaluarën e pemës, por janë faktotë të vetë mbijetesës së saj; Europa e ëndërruar ose do të jetë pemë e këtyre rrënjëve ose nuk do të jetë fare. (Fq. 45)

“RRËMBIMI I EUROPËS” (Fq. 47)

(Duke folur për prejardhjen e emrit “Europë”, Aurel Plasari shkruan:

“Po prejardhja e vetë emrit? ... Enciklopedia e vjetër frënge e bën të vijë prej fjalës fenikase *herb*, që dashkësh me thënë “perëndim”, vend ku ulet dielli.

Një interpretim tjetër mund të gjendet tek “Atlasi i gjeografisë antike dhe modern” i botuar më 1829 nga Lapiété, atë e bir: aty termi paraqitet me etimologji kelte. Simbas dy gjeografëve në keltishte termi *wreb* paskësh kuptimin po “perëndim”. Një interpretim i tretë e mëton ardhjen e emrit prej fjalës semite *ereb*, që dashkësh me thënë “muzg, mbrëmje”, çfarë i bënte historianët të pohonin se

për popujt e lashtë “Oksidenti” ishte vendi ku “perëndonte dielli”, visi i t’errtit, ...Edhe nga mitologjia greke rezultonte një Erebos, bir i Kaosit dhe vëlla i Natës. Ngjan, në këtë pikë, se mëtohet së tepërmi, por vërtet së tepërmi, nga një term i vetëm! (Fq. 51) Shënim: Kjo pjesë do duhej të bënte pjesë në librin: “Indoeuropa” ose në librin “Takim me Pellazgun”)

Tek “Vija e Teodosit rishfaqet (1993) pata kujtuar: Pikërisht para rrezikut turk zuri të shfaqej gjithnjë e më shpesh në dokumentat e kancelerive të kontinentit adjektivi *europian* dhe substantive “*Europë*”. Si pata vënë re: “Historianët janë të mendimit se është hera e parë që shfaqet ky adjektiv, si dhe që Europa përkufizohet si refuzim i Islamit. Është një identifikim mes kontinentit dhe kristianitetit dhe në këtë kuptim, nuk mund t’ua mohosh të drejtën historianëve që thonë se vetë koncepti *europian* ka lindur në ballafaqim e sipër me Islamin”. (“Vija e Teodosit rishfaqet”, f. 53). (Fq. 61).

Dhe jo rastësisht Europa karlovingje përkon me atë që në epokën modern do të quhej “Europë e të Gjashtëve”. Asokohe më shumë se Europë, quhej *Universitas Christiana*, sepse, ndonëse emri Europë ishte “caktuar” duke nisur, së paku, nga shek. VII, parapëlqehet emri *Krishterim*. Përse? Sepse çfarë ngrinte peshë nuk ishte territori, por besimi që diktonte një mënyrë të qeni dhe përkufizonte njësinë (unitetin) e një grupi të madh njerëzish të cilët, duke qenë të krishterë, e ndienin veten të lirë së brendshmi. (Fq. 62).

Kur shpërthente Lufta e Parë Botërore armiqtë e Gjermanisë, si Franca, Anglia dhe mandej SHBA u përpoqën “ta hiqnin qafe” Gjermaninë duke e trajtuar si “joEuropiane”, d.m.th., duke e përjashtuar atë nga Europa. U përsërit kjo edhe gjatë Luftës së Dytë. Ndërsa gjatë kohës së “Luftës së Ftohtë” papritur e pakujtuar Gjermania shfaqej jo vetëm si pjesë e Europës, por gati-gati si “bërthamë” e saj. Sikurse shihet, Europa na dalkësh një “vis” i paçanësuar mirë. Në kuptimin gjeografik ajo nuk shfaqet si ndonjë hapësirë me caqe të vëna qartë. Kjo hapësirë përcaktohet herë në

një mënyrë, herë në një tjetër. Por: a mbetet ndonjë kuptim i saj i pandryshuar? (Fq. 69 - 70)

Gadishull Ilirik: ky ishte emërtimi i lashtë që kishte trashëguar rajoni ynë prej Antikitetit dhe Mesjetës së hershme. I ngulitur prej autorëve që shkruanin nga Roma, ky emërtim dëftonte se gadishulli nuk përbënte gjë tjetër pos se Ilirikun sipas idesë administrative romane. Me pushtimin e tij prej romanëve ai nisi të quhej edhe Gadishull Roman, sikurse me zhvendosjen e kryeqytetit të Perandorisë nga Roma në Bizant do të emërtohej ndonjëherë edhe Gadishull Bizantin. Sikurse shihet është fjala, deri në këtë kohë, për emërtime politike ose historike. (Fq. 75)

(*Shënim B.P.*: Kur flitet për “Gadishull Ilirik” përse të mos barasvlerësohet me termat: “Gadishulli Iberik” apo “Gadishulli Italik apo Apenin”)

Nga ana tjetër, as vetë emri *Ballkan* në vend të atij *Haemus* nuk është i saktë, mbasi *Ballkan* në turqisht do të thotë “mal”. Ndaj tallej Konica: “*Malet Ballkan* do të thotë pra malet *Mal*”. (Fq. 79)

Qortimit të këtij gabimi flagrant konceptual, dhe mundësisht ndreqjes së tij, i shërbeu orvajtja e një grupi gjeografësh gjermanë në fillim të shek. XX për emërtimin e gadishullit si Sudost-Europäische Halbinsel, d.m.th. Gadishull i Europës juglindore. (Fq. 79 - 80)

E ka pas thënë Konica: “Emri *Europë* në kohët klasike i vihej vetëm “Ballkanit”, dhe vetëm në Kohën e Mesme ai u shtri në pjesën tjetër të kontinentit të bardhë!” (Fq. 80)

Ndërsa shqyrtonte zhvillimet e kontinentit tonë mbas Luftës së Dytë Botërore, Thomas S. Elioti shprehte pikëpamjen se një rrezik vdekjeprurës i kërcënohej qytetërimit evropian prej atyre që ai i quante “kufij intelektualë të Europës së mbyllur”, shfaqur qysh në kohën e ngritjes së shteteve-kombe. “Një lloj autarkie kulturore vjen në mënyrë të pashmangshme mbas autarkisë politike dhe ekonomike”, vërente ai. (Fq. 81)

Është e kuptueshme që jo vetëm Ahmatova me ëndrrën e saj për viset ku Euridikat “bredhin gjithmonë” apo ku Europën “një dem e ngre”, por poetët e mbarë kontinentit i janë kthyer dhe do të vijojnë t’i rikthehen, me nostalgji atavike, zonës së privilegjuar që bën pjesë në mënyrë të padiskutueshme në zanafillën e trashëgimisë së përbashkët europiane: “Europës së Vjetër”. (Fq. 82).

“EUROPA SI SHPIRT” (Fq. 83)

Është e njohur formula e Gëtes (Goethes), të cilën ai ia transmetonte sekretarit të tij: “Çfarë e bashkon Europën është kultura, ndërsa çfarë e ndan janë idetë politikë” (Gespräche, 14 Maj 1808). (Fq. 85)

... mbetet ende në fuqi pyetja: Ç’është Europa? ... (Fq. 86)

Përgjigjen kësaj pyetjeje ja ka dhënë historia dhe ajo vjen pak a shumë kështu: Europa nuk është një strukturë thjesht gjeografike, por një strukturë piksëpari kulturore, gjë që mendimtarë si Gëteja (Goetheja) e kishin kuptuar qysh moti. Kufijtë e kësaj Europe kanë qenë vendosur në bazë të shpirtit, frymës, dhe jo mbi parime gjeofizike. Poeti dhe mendimtari Pol Valery i ka pas dëftuar këta kufij realë në një ese me titull “*La crise de l’esprit*”, të pranuar botërisht si “manifesti europian” prej etërve të integritimit europian (Nouvelle Revue Française, nr.8, 1919). Simbas Valerysë: Europa ekziston atje ku zotëron ndikimi i besimit të krishterë, i botës latine dhe i letërsisë helene. Pra: as bota greke vetëm, dhe as ajo latine vetëm, pa Krishterimin, nuk kanë mundur të konstitujnë Europën. (Fq. 86 - 87).

...e vërteta mbetet se, që Europa të lindej, u desh të shfaqej *Krishterimi*. Dhe kjo ndodhi ngase Krishterimi mori në duart e veta edukimin helen, si edhe traditën romane të së drejtës, duke ia dalë të realizojë një sintezë unikale me rëndësi vendimtare në histori. (Fq. 88)

Tejkapërcimi i mjedisit *hebré* prej Krishterimit dhe hapja e tij ndaj fiseve dhe popujve që faktor parësor për lindjen e Europës. Falë kësaj hapjeje Krishterimi nuk mbeti një “fe kombëtare”, por pranoi si të barabartë njerëzit e ardhur prej çdo fisi e populli, çdo

vendi dhe shtrese sociale, duke u ofruar një identitet të përbashkët të gjithëve dhe duke përfituar kështu ndjenjën se të gjithë i përkasin së njëjtës botë dhe se mes tyre nuk ka kufij: një e vërtetë themelore që gabimisht mund të na duket si zbulim i njeriut modern. (Fq. 89)

Kështu u ngrit *Shtëpia Europiane*: falë faktit që të krishterët:

Ruajtën edukimin helen

Mbajtën traditën romane të së drejtës, duke i bindur “barbarët”, që ligji ka rëndësi më shumë se shteti, por sidomos

Luftuan për shndrrimin e një perandorie mizore në një republikë të krishterë: *Respublica Christiana*. (Fq. 90)

Porse fakti që nuk mund të vihet në dyshim, dhe as mund të fshihet, është që Europa u lind në oborrin e Kishës. Tani që nga çdo anë po përpiqen ta bashkojnë, do të ishte me vend të mbahet parasysh që ajo u pat lindur në atë oborr me objektivin e njësisë (unitetit) së saj, ideal që braktiset nëse ndiqen ideologjitë politike apo “interesat ekonomike”. (Fq. 113). Ata që dëshirojnë vërtet një *Europë*, do të duhet të marrin edhe përgjegjësinë e kësaj Europe, të mbajnë përsëri si ideal njësinë (unitetin) e popujve të saj. Do të duhet atëhere të pranohet, si në kushtetutën e saj, ashtu edhe në jetën e saj politike, të përditshme e ndoshta edhe të rëndomtë, se kur thuhet *Europë* flitet për një kulturë, për një shpirt të caktuar, një shpirt që ka për at Krishterimin dhe se ky shpirt i Europës lypset ruajtur, ashtu si edhe trupi i saj. (Fq. 116)

2. ARMENËT DHE BASHKËSIA E POPUJVE EUROPIANË

A. Kontakti me botën dhe edukatën Helene

Aleksandri i Maqedonisë

Dihet që, Armenët kishin qenë pjesë përbërëse e ushtrive Akemenase në të dyja betejat e humbura më parë ndaj Aleksandrit, në atë të Issosit dhe të Gaugamelës.

(Historia e Armenisë, fq. 48)

Në betejën e Gaugamelës (ashtu si edhe në atë të Issosit), Armenët ishin pjesë përbërëse e trupave të Akemenëve dhe fuqia kryesore e tyre në krahun e djathtë duke e udhëhequr atë.

(Historia e Armenisë, fq. 48)

Përballja ushtarake e rradhës ndërmjet Maqedonasve dhe Armenëve ndodhi pas 2-3 vjetësh, kur Aleksandri dërgoi një nga njësitë e tij ushtarake të udhëhequr nga gjenerali Menon në zonën e Armenisë së Lartë, që ishte e pasur me mineral ari. Siç dëshmon kronikani Grek, Straboni, Armenët e asgjësuan atë njësi, kurse “gjeneralin e mbytën”. Pas kësaj, Aleksandri nuk bëri përçapje të tjera për të dërguar ushtri në Armeni. Faktet e njohura bëjnë me dije, që Aleksandri i Maqedonisë ishte i detyruar ta merrte në konsideratë fuqinë ushtarake Armene dhe t’i shmangej një përballjeje të re me ta.

(Historia e Armenisë, fq. 48)

Aleksandri vdiq në vitin 323 para Krishtit, në moshën 33 vjeçare. Nëpërmjet fushatave të tij, në Azinë Perëndimore hyn Helenizmi dhe fillon epoka e Helenizimit (Greqizimit). Në këtë epokë Armenia hyn me pavarësi të plotë.

(Historia e Armenisë, fq. 49)

Periodha Seleucide (Greke) (Në kontakt me botën greke)

Pas vdekjes së Aleksandrit në vitin 323 para Krishtit “deri në vitet 190 para Krishtit, kur në Azinë e Vogël, pranë qytetit Magnesia, u zhvillua beteja vendimtare ndërmjet Seleucidëve dhe Romakëve, e cila përfundoi me humbjen e thellë të Antiokosit” historia e Armenisë është një betejë e vazhdueshme ndërmjet Armenëve dhe Seleucidëve, deri sa në vitin 190 para Krishtit “Të ndihmuar nga rrethanat e krijuara, Armenët rifituan pavarësinë.”

(Historia e Armenisë, fq. 51)

Në periudhën e helenizimit, perëndive Armene ju vendosën korrespondenca me perënditë Greke (Aramzd - Zeusi, Anahit – Artemisi, Vahag – Heraklesi, Astik – Afrodita, Arek – Heliosi, Tir – Apolloni, etj).

(Historia e Armenisë, fq. 80)

Nga Armenia paraKristiane janë zbuluar monumente të kulturës shkrimore, të cilat sipas kohës së krijimit dhe përmbajtjes që transmetojnë, mund të ndahen në katër grupe:

1. Sisteme shkrimi të krijuara brenda Armenisë dhe të përdorura nëpër tempujt nga paraardhësit e lashtë. Këtij grupi, pjesërisht të dëshifruar, i përket vetëm shkrimi tempullor i mbretërisë së Vanit, i cili është i përbërë nga rreth 300 simbole (shenja), të shkruara nga e djathta në të majtë dhe nga lart-poshtë. Gjuha e përdorur në këtë lloj shkrimi konsiderohet Armenishtja më e vjetër.
2. Grupin e dytë e përbëjnë sisteme shkrimi që nuk kanë Armeninë si vendlindje, por që janë përdorur në sistemet shkrimore të paraardhësve të lashtë Armenë. Në të futen sistemet shkrimore si: Hieroglifet Hittito-Luviakane, shkrimet kuneiforme (në formë pyke) Asuro-Babilonase dhe ato vendase (të quajtura Biajniliiane ose Urartiane), alfabetet Greke, Aramaike, Asore dhe Pahlavi ose të Persishtes së mesme.
3. Grupin e tretë e përbëjnë sende të ndryshme të shkruara, të gjetura në vendbanime të lashta Armene, autorët e të cilave nuk janë Armenë.
4. Grupin e katërt e përbëjnë monumentet me mbishkrime me simbole misterioze, të cilat nuk njihen jashtë Armenisë.

(Historia e Armenisë, fq. 83-84)

Informacione të rëndësishme historike jepen edhe nga mbishkrimet monumentale me germa Greke apo Arameike, të lëna nga mbretërit Armenë, të cilat fillojnë nga shek. i 3^{te} para Krishtit deri në vitin 301.

(Historia e Armenisë, fq. 85)

Në shek. e 3^{te} para Krishtit, në Armeni fillon epoka Helenike, e cila zgjat deri në periudhën kur Kristianizmi bëhet fe shtetërore në Armeni.

(Historia e Armenisë, fq. 86)

Në periudhën Helenike në Armeni u ndërtuan teatro në të cilat luheshin shfaqje për aristokracinë e lartë. Është i njohur fakti, që të tilla teatro kanë funksionuar edhe në Artashat dhe Tigranakert. Brenda tyre luheshin pjesë të autorëve Grekë, si edhe të autorëve Armenë. Sipas dëshmisë së Plutarkut (shek. 1-2), tragjeditë e shkruara prej Artavazdit të 2^{te}, edhe një shekull e gjysëm pas vdekjes së tij, ishin të njohura nga lexuesit e apasionuar Romakë të letërsisë.

Për jetën teatrale të periudhës së vonë Helenike, një dëshmi e veçantë është ajo e çajnikut prej argjendi me mbishkrime në gjuhën Greke e mbretit Bakur (në vitet 160), i cili është i pasur me figura teatrale.

(Historia e Armenisë, fq. 88)

Gjatë shek. të 4^e u përkthyen veprat e shkruara në gjuhën Greke dhe me vlerë historike, nga të cilat padyshim më të rëndësishmet ishin veprat e Agatangelosit dhe Paustos Bizantit.

(Historia e Armenisë, fq. 114)

Në fushën e mendimit shkencor (bëhet fjalë për periudhën ndërmjet shek. 9 – 14) vazhdonte të mbetej mbizotërues Neoplatonizmi (Platonizmi i ri) (përfaqësuesi më në zë i së cilës ishte Davit Anhahti), një nga idetë origjinale të të cilit ishte mundësia

e njeriut për t'i ngjarë Zotit, për t'ju afruar atij dhe për t'u shkrirë me të, mundësi këto që njeriu mund t'i bënte realitet nëpërmjet veprimtarisë mendore dhe shpirtërore. Kjo ide përshkon si një fill i kuq të gjithë faqet e veprës brilante të Grigor Narekacit (951-1003) "Libri i Tragjedisë".

(Historia e Armenisë, fq. 136)

B. Kontakti me botën Romake dhe Bizantine

Periudha Romake (Në kontakt me botën romake)

Pas betejës së Magnesisë në vitin 190^e para Krishtit, të ndihmuar nga rrethanet e krijuara, Artashesi në Ameninë e Madhe dhe Zarehu në Armeninë e Vogël arritën të risjellin pavarësinë në këto vende. Romakët e njohën menjëherë pavarësinë e tyre.

(Historia e Armenisë, fq. 54)

Pas këtij viti fillon një periudhë e gjatë pajtimesh dhe grindjesh të vazhdueshme ndërmjet mbretërve Armenë dhe Perandorisë Romake e cila në më të shumtën e rasteve nxitet edhe nga sundimtarët Persë të cilët synonin dobësimin e dy të parëve për të përfituar vetë. (*Shënim i autorit B.P.*)

Në vitin 76 u ndërtua edhe fortesa dhe tempulli në Garni. (*Shënim B.P.: sipas modelit të tempujve Romakë*)

(Historia e Armenisë, fq. 72)

C. Kontakti me botën e Krishterë

Ngjarja, ndoshta më e madhja, që solli një kthesë rrënjësore në historinë Armene, ishte shpallja e Kristianizmit si fe zyrtare shtetërore, me të cilën fillon ndarja e historisë së Armenisë në dy periudha: ajo e para Kristianizmit dhe ajo Kristiane.

(Historia e Armenisë, fq. 91)

Sipas gojëdhënës, kjo ka ndodhur në vitin 301 (brenda historiografisë ka edhe zëra ndryshe lidhur me këtë datë).

(Historia e Armenisë, fq. 93)

Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet që: Krishterimi hyri në Armeni në shekujt 1-3, në fillim të shek. të 4^t u shpall fe zyrtare shtetërore, ndërsa Kisha Armene, si Kishë me organizim të pavarur kombëtar, mori trajtën e saj përfundimtare përgjatë shekujve 4-6.

(Historia e Armenisë, fq. 94)

III

LIDHJET E NGUSHTA HISTORIKE ME KANCELERITË EUROPIANE

Levoni i Iltë (sundoi 1187-1219) nënshkroi marrëveshje të privileguara me Venedikun, Gjenovën, Pizën, dhe me qytete e vende të tjera. Ai krijoi marrëdhënie të ngrohta (madje bëri edhe krushqi) me shtëpitë mbretërore qeverisëse të krishtera.

(Historia e Armenisë, fq. 132)

Varri i Levonit të IV^{të} (vdiq 1396) ndodhet në Paris, brenda Mauzoleut Mbretëror në Tempullin Sen Deni.

(Historia e Armenisë, fq. 133)

PËRMBYLLJE

POZICIONI I ARMENISË DHE ARMENËVE NË BASHKËSINË E POPUJVE EUROPIANË

Nëse historia nuk do të fliste për një luftë Troje, për një Iliadë apo një Odise, si do ta fillonte e ashtuquajtura “Europë” historinë e saj, me se do të krenohej Perëndimi European, dhe mbase, edhe ai mbarë botëror në mos po me edukatën, kulturën dhe demokracinë Greke, me civilizimin Romak që përbën sot bazën e organizimit shtetëror perëndimor, me ideologjinë Kristiane që u mbrujt në gadishullin Anatolik dhe vuri gurin e parë të themelit me kishën e parë të njohur zyrtarisht në Armeni e që më pas u zyrtarizua në të gjithë Perandorinë Romake.

Nëse ideologjia e Krishterë sot përbën një nga tre shtyllat kryesore mbi të cilën u ngrit ngrehina e ashtuquajtur “Bashkësia Europiane” është e pamundur të mohosh meritën e atij kombi të vogël (Armen), që njihet si streha e parë e lirë e besimtarëve kristianë, e që edhe sot del si ishull mbi detin e përmbytjes osmane afro njëmijë vjecare mbi gadishullin Anatolik, Bizantin, apo të ashtuquajturës “Perandori Romake të Lindjes”.

Ashtu si kombi shqiptar i dha Europës shpatën dhe mburojën në mesin e shek. XV dhe frenoi invazionin Osman drej Perëndimit të krishterë, duke i bërë kësaj një shërbim të paçmueshëm

qytetërimin të sotëm Europian dhe mbase edhe atij mbarë botëror duke sakrifikuar copë nga shpirti i tij i krishterë (Shqipëria sot është një vend ku bashkëjetojnë besimi Kristian me atë Mysliman), ashtu edhe Armenia sakrifikoi pjesë të trupit të saj material dhe shpirtëror, për të mbetur ajo që është sot, një Feniks me krahë të cunguar, që duke luftuar me dhimbjen që i shkaktojnë plagët e marra ndër shekuj të gjatë dhe furi njerëzore aspak miqësore, përpiqet të ngrihet në fluturim ashtu siç është në natyrën e tij, si një zog i lirë që di të ringrihet mbi furtunat e kohëve dhe të përçojë mesazhin e lashtë sa vetë jeta, mesazhin e ringjalljes dhe të dashurisë për jetën. Dhe kush mund ta përçojë më mirë këtë mesazh se sa popujt që në gjithë qënien e tyre janë të mbrujtur me besimin e fuqishëm të mbijetesës mbi dallgët e fuqishme mbi të cilat e përkund jeta.

Armenia është pjesë e Europës dhe e tillë do të mbetet deri sa të jetë gjallë; dhe populli Armen do jetë pjesë e komunitetit Europian përderisa të ketë ngelur edhe një Armen i vetëm që e quan veten Armen. Dhe është detyrë e tij ta ruajë fort follenë e tij, atë pjesëz skajore të Europës që ka mbetur e pacënuar në shpirtin e saj Kristian, atë pjesëz Europe që vazhdon të ruajë vlerat e civilizimit Latin dhe edukimit Helen.

Dhe është detyrë e Europës të kujtohet për bijtë e saj, për sakrificat e tyre në mbrojtje të vlerave të saj, dhe është detyrë e Europës të ruajë kufijtë e saj, dhe është detyrë e Europës të kujdeset dhe të mbrojë bijtë e saj.

Pa Shqipërinë dhe Armeninë Europa do të ishte një histori IndoEuropiane e cunguar në trup dhe në shpirt.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Piranjani, Berzh

Armenia : ky skaj i harruar i Europës pellazgjike /
Berzh Piranjani . - Tiranë : Integrafika, 2023.

32 f. ; 14 x 21 cm,

ISBN 978-9928-34-318-5

1.Qytetërimi 2.Armenë 3.Historia 4.Armeni

008(=19)

Çmimi 320 Lekë

